



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE

KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 27 Janar 2022

Nr: 25

V E N D I M

P Ë R

**NGRITJEN DHE THIRRJEN E MBLEDHJES SË PARË TË KOMISIONEVE TË ZONAVE TË ADMINISTRIMIT ZGJEDHOR TË ZAZ-VE NR. 2, NR. 3, NR. 4, NR. 5, NR. 19, NR. 21, NR. 22, NR. 23, NR. 24, NR. 26, NR. 43, NR. 54, NR. 55 PËR ZGJEDHJET E PJESSHME VENDORE PËR KRYETAR BASHKIE NË BASHKITË SHKODËR, DIBËR, DURRËS, VORË, RROGOZHINË DHE LUSHNJË TË DATËS 6 MARS 2022**

Në mbështetje të Dekretit të Presidentit të Republikës nr. 13438, datë 20.01.2022, “Për caktimin e datës së zgjedhjeve të pjesshme vendore për kryetar bashkie për disa njësi të qeverisjes vendore”, të nenit 19, pikat 1, shkronjat “b” e “n”, dhe 2, nenit 28, pika 1, nenit 93, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve

V Ë R E N:

Bazuar në nenin 28, pika 2, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar si dhe të nenit 8, të Rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor”, miratuar me vendimin nr. 5, datë 20.11.2020, të Komisionit Rregullator, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve:

- merr vendim për ngritjen e KZAZ-ve jo më vonë se 10 ditë nga data e nxjerrjes së dekretit të Presidentit;
- përcakton njësinë administrative, selinë dhe orën ku do të zhvillohet mbledhja e parë e KZAZ-ve;
- njofton partitë politike, të cilat kanë propozuar anëtarët e KZAZ-ve, për datën, vendin dhe orën e mbledhjes së parë të KZAZ-së.



Data: 27 Janar 2022

Nr. 25

“Për ngritjen dhe thirrjen e mbledhjes së parë të Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022”

Të gjitha ndërtesat e caktuara nga njësitë e qeverisjes vendore, për krijimin e selive të KZAZ-ve, janë në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenin 93, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pikat 1, shkronjat “b” e “n”, dhe 2, nenin 28, pika 1, nenin 93, pika 1, të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar,

### **V E N D O S I:**

1. Ngritjen e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor, për zgjedhjet e pjeshme vendore për kryetar bashkie të datës 6 Mars 2022.
2. Mbledhja e parë e Komisioneve të Zonave të Administrimit Zgjedhor do të zhvillohet në selitë e KZAZ-ve, në datën 28.01.2022, në selitë e përcaktuara në lidhjen 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi.
3. Orari i zhvillimit të mbledhjes së parë të KZAZ-ve do të jetë nga ora 10:00 deri në orën 17:00, me njoftim paraprak për çdo KZAZ.
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim brenda 24 (njëzet e katër) orëve në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve, nga publikimi.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Ilirjan CELIBASHI**



Qarku	Bashkia	ZAZ	Njësia administrative ku do të ngrihet selia e KZAZ	Adresa e Selive të KZAZ-ve	Data
Shkodër	Shkodër	02	Shkodër	Bulevardi "Bujar Bishanaku", Pallati i Sportit "Qazim Dervishi"	1/28/2022
		03	Shkodër	Rruga "Kongresi i Manastirit", Palestra e shkollës "Ismail Qemali"	
		04	Shkodër	Rruga e "Myzafer Pipa", Palestra e shkollës "Shenjaze Juka"	
		05	Shkodër	Rruga "Kadukej" Shkolla 9- vjecare "Xheladin Fishta"	
Dibër	Dibër	19	Peshkopi	Qendra e Edukimit dhe Komunikimit	
Durrës	Durrës	21	Sukth	Shkolla 9-vjeçare "Njazi Mastori"	
		22	Durrës	Shkolla 9- vjeçare "Marie Kaculini"	
		23	Durrës	Shkolla e muzikës "Jan Kukuzeli"	
		24	Durrës	Shkolla e mesme "Leonik Tomeo"	
Tiranë	Vorë	26	Vorë	Shkolla 9 vjeçare Marqinet 2	
	Rrogzhinë	43	Rrogzhinë	Shkolla e mesme "Haxhi Qehaj"	
Fier	Lushnjë	54	Lushnjë	Palestra e shkollës "Skënder Libohova"	
		55	Lushnjë	Shëtitorja "Kongresi", Holli i Muzeut Historik	